

SHPLLJE PËR SHPREHJE INTERESI PËR PËRZGJEDHJEN E KOORDINATORËVE KUNDËR KORRUPSIONIT

Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit (DPAK), institucion publik buxhetor në varësi të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, me seli në Tiranë, shpall procedurën për paraqitjen e shprehjeve të interesit nga kandidatët e interesuar për t'u përzgjedhur dhe emëruar në pozicionin e Koordinatorit Kundër Korrupsionit, në institucionet e përcaktuara në Aneksin nr. 1, bashkëlidhur kësaj shpalljeje.

DPAK ka si mision parandalimin dhe goditjen e korrupsionit në institucionet e administratës shtetërore, entet publike dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror.

🚩 KRITERET E PËRGJITHSHME

Kandidati duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- c) ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;
- ç) të mos ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit në ushtrimin e detyrës, sipas legjislacionit në fuqi;
- d) të jetë në gjendje shëndetësore që i mundëson ushtrimin e detyrës;
- dh) të mos ketë çështje penale nën hetim ose gjykim të iniciuar ndaj tij.

🚩 KRITERET E POSAÇME

Kandidati duhet:

- a) të zotërojë diplomë të nivelit “Master i Shkencave” ose “Master Profesional”, të përfituar pas përfundimit të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe kohëzgjatje normale dy vite akademike, në fushat e përcaktuara sipas kërkesave të institucionit përkatës;
- b) të ketë të paktën 2 (dy) vite përvojë pune në profesion.

KRITERI NDALUES

Kandidati nuk mund të aplikojë për pozicionin e Koordinatorit Kundër Korrupsionit pranë një institucioni ku kandidati ka qenë i punësuar në atë institucion për një periudhë mbi 3 (tre) muaj të njëpasnjëshëm gjatë 3 (tre) viteve të fundit.

PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I DETYRAVE

Koordinatori Kundër Korrupsionit ushtron, ndër të tjera, këto detyra:

- a) mbledh informacion mbi veprimtari korruptive, praktika abuzive ose arbitrare nga burime të ndryshme dhe kryen verifikime administrative;
- b) bashkëpunon me strukturat e brendshme të institucionit për shqyrtimin e rasteve të dyshuara të korrupsionit;
- c) vlerëson rrezikun e korrupsionit, duke analizuar mundësitë e shfaqjes së formave të veçanta të korrupsionit;
- ç) harton raportin përfundimtar të rastit dhe e përcjell pranë DPAK;
- d) ndjek dhe raporton pranë DPAK-së zbatimin e rekomandimeve të marra nga institucioni përkatës;
- dh) kryen çdo detyrë tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

DOKUMENTACIONI I APLIKIMIT

Kandidati duhet të dorëzojë nëpërmjet shërbimit postar ose duke u paraqitur fizikisht në ambientet e DPAK, dokumentet e mëposhtme, në origjinal ose kopje të noterizuara:

- a) kërkesë për shprehje interesi, ku të specifikohet institucioni/institucionet për të cilat shpreh interes;
- b) jetëshkrim (CV) të përditësuar;
- c) kopje të dokumentit të identifikimit;
- ç) diplomë Bachelor dhe Master; për diplomat e marra jashtë vendit duhet të paraqitet akti i njohjes/njësimit nga institucioni kompetent;
- d) vërtetim nga punëdhënësi aktual ose i fundit që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- dh) vërtetim mjekësor për gjendjen shëndetësore;
- e) dëshmi penaliteti;
- ë) vërtetim nga prokuroria që nuk është nën hetim dhe nga gjykata që nuk është në gjykim;
- f) dokumentacion që vërteton përvojën e punës (libreza e punës, vërtetim nga e-albania);

- g) dokumentacion që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë dhe referencat e deklaruara në CV;
- gj) deklaratë të nënshkruar mbi vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur;
- h) formularin e vetëdeklarimit sipas legjislacionit për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.

Mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar përbën shkak për skualifikim.

PROCEDURA E VLERËSIMIT

Procedura e konkurrimit zhvillohet në dy faza:

1. Verifikimi paraprak i dokumentacionit;
2. Zhvillimi i intervistës.

Kandidati konsiderohet i kualifikuar për vijimin e procedurës nëse vlerësohet me jo më pak se 60 (gjashtëdhjetë) pikë nga 100 (njëqind) pikë në total.

Në përfundim të vlerësimit, renditja e kandidatëve të kualifikuar përcaktohet në bazë të pikëzimit. Përzgjedhja për pozicionin përkatës kryhet duke filluar nga kandidati me pikëzimin më të lartë, në rend zbritës, deri në plotësimin e pozicioneve të lira.

PROGRAMI I INTERVISTËS

Kandidatët do të testohen mbi njohuritë e tyre lidhur me:

- a) Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- b) Ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- c) Ligjin nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”
- ç) Vendimin nr. 522, datë 25.9.2025, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin”;
- d) Vendimin nr. 436, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit”;
- dh) Legjislacionin sektorial specifik që rregullon fushën e veprimtarisë së institucionin për të cilin ka shprehur interes.

Në varësi të institucionit për të cilin është paraqitur shprehja e interesit, testimi i kandidatëve përfshin edhe njohuritë mbi legjislacionin sektorial specifik që rregullon fushën e veprimtarisë së institucionit përkatës, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e tij ligjore.

Kandidatët që kanë shprehur interes për institucionet: Drejtoria e Pronave Shtetërore, DVASHK Tirana Jug, DVASHK Tirana Rurale II, DVASHK Vlorë dhe DVASHK Shkodër do të testohen edhe për njohuritë mbi:

- Ligjin nr. 111/2018 “Për kadastrën”;
- Ligjin nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

Për kandidatët që kanë shprehur interes për institucionet: Inspektoriati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit, Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial do të testohen edhe për njohuritë mbi:

- Ligjin nr. 9780/2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Për kandidatët që kanë shprehur interes për institucionet: Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Spitali Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni” do të testohen edhe për njohuritë mbi:

- Ligjin nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 10138, datë 11.5.2009, “Për shëndetin publik”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 105/2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar;
- Vendimin nr. 419, datë 4.7.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor”.

Për kandidatët që kanë shprehur interes për Operatorin e Blerjeve të Përqendruara sh.a. do të testohen edhe për njohuritë mbi:

- Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;
- Vendimin nr. 531, datë 7.9.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sh.a., për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrave dhe institucioneve të varësisë”, i ndryshuar.

Për kandidatët që kanë shprehur interes për Posta Shqiptare sh.a. do të testohen edhe për njohuritë mbi:

- Ligjin nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

AFATET DHE NJOFTIMET

Afati i fundit për paraqitjen e kërkesave për shprehje interesi është data 12.6.2026. Aplikimet e paraqitura pas këtij afati nuk do të merren në shqyrtim.

Në rast se dokumentacioni rezulton i paplotë, kandidati njoftohet dhe i jepet një afat prej 5 (pesë) ditësh kalendarike për plotësimin e tij. Mosplotësimi i dokumentacionit brenda afatit sjell përjashtimin nga procedura e konkurrimit.

Pas përfundimit të verifikimit paraprak dhe shqyrtimit të çdo ankimi, Komisioni miraton listën përfundimtare të kandidatëve të kualifikuar dhe përcakton datën e zhvillimit të intervistës.

Çdo njoftim lidhur me procedurën e konkurrimit do t’u komunikohet kandidatëve në adresën elektronike të deklaruar në CV.

Lista përfundimtare e kandidatëve fitues dhe institucionet përkatëse ku ata do të emërohen do të publikohet në faqen zyrtare të DPAK-së.

Në mënyrë të detajuar, procedura e rekrutimit është parashikuar në Kreun IV të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit”, miratuar me Urdhrin nr. 03, datë 4.6.2025, të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionit, e publikuar në faqen zyrtare të DPAK-së.

** Ky version zëvendëson çdo version të mëparshëm të shpalljes. Kandidatët dhe të interesuarit duhet t’i referohen këtij versioni të përditësuar të shpalljes.*

Aneks 1

Nr.	Institucioni
1	Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
2	Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore
3	Drejtoria e Pronave Shtetërore në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës
4	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Jug
5	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale II
6	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Vlorë
7	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Shkodër
8	Inspektoriati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit
9	Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
10	Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial
11	Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor
12	Posta Shqiptare sh.a
13	Spitali Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”
14	Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”